

RENDI I DITËS

Shorti “Për caktimin e relatorëve të kërkesës ankimore nr. 9 dhe 10”.


PJESËMARRJA :

- **Stafi KQZ: Znj. M. Çelmeta, z. E. Mema.**

Znj. M. Çelmeta: Përshëndetje, sot me datë 6 gusht 2024 do të zhvillohet procedura e hedhjes së shortit për përcaktimin e relatorit, për dy kërkesa ankimore të depozituara pranë KQZ-së. Kërkesa ankimore nr.9, me ankues “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut” dhe kërkesa ankimore nr. 10, me ankues z.Dhionisios Fred Beleri. Të dy këto ankime kanë të njëjtin objekt “Kundërshtimi i vendimit nr.69, datë 5.07.2024, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z.Dhionisios Fred Beleri, propozuar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”. Procedura e hedhjes së shortit është parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur pesë shirita letre, ku në dy prej tyre janë shënuar “Kërkesë ankimore nr.9”, “Kërkesë ankimore nr.10”, tre shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime, të cilët do të futen në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Atëherë fillojmë me futjen e shiritave. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, kanë autorizuar një përfaqësues nga KQZ-së të tërheqë goglat, në emër dhe për llogari të tyre, për caktimin e relatorit. Pasi përziejmë goglat, vazhdojmë me rendin alfabetik ngjithës, duke filluar nga z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. Ilirjan Rusmali, z.Koli Bele dhe z. Ledio Braho. Vijojejmë, hapim goglën e parë.

Zoti Elvin Lako: – Fleta është e bardhë dhe pa shënim.

**Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 06.08.2024*

Vazhdojmë me:

Zotin Elvis Çefa: – Fleta është e bardhë dhe pa shënim.

Vazhdojmë me:

Zotin Ilirjan Rusmali: – Fleta është e bardhë dhe pa shënim.

Vazhdojmë me:

Zotin Koli Bele: – Kërkesa ankimore nr. 9.

Vazhdojmë me:

Zotin Ledio Braho: – Kërkesa ankimore nr. 10.

Atëherë, në përfundim të procedurës së shortit për kërkesën ankimore nr.9, relator është zoti Koli Bele dhe për kërkesën ankimore nr.10, relator është zoti Ledio Braho.
Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

